




SHPËRFAQJA E POEZISË RUSE PËRMES PËRKTHIMIT SHQIP

Shënime mbi monografinë
SHENJA TË MUNGUARA NË LETRAT SHQIPE
të autorit Korab Hoxha

STUDIMI monografik i Prof. Asoc. Korab Hoxhës “Shenja të munguara në letrat shqipe” është i një profili specifik, nga ata që i kemi të pakët, ose pothuaj të munguar fare tek ne. Në këtë studim, merret përsipër të hulumtohet mbi traditën përkthimore në shqip prej letërsive të tjera, e në këtë rast, veçmas, prej poezisë ruse. Përkthyes të shquar kemi pasur e kemi, madje mund të flitet për një *shkollë shqiptare të përkthimit*. Kemi gjithashtu një bibliotekë të përkthimeve nga proza e sidomos nga poezia ruse, por nuk kemi pasur ende gjer më sot një studim tërësor të këtillë, ku të hetohen rezultatet dhe problematikat e këtij lëvrimi përkthimor, të parë në një rrafsh krahasimtar praktik e teorik.

Duke lexuar studimin monografik të K. Hoxhës, mund të thuhet se aty vërehen të alternuara dy zgjedhje. Duhet kujtuar se autori rezulton të jetë një njohës i mirë i gjuhës dhe i letërsisë ruse, madje zotëron edhe atë shqisën, që e ndihmon aq shumë përkthyesin e poezisë, pra, të marrët prej vitesh me krijimtari poetike. Disa prej këtyre krijimeve poetike, janë botuar nëpër libra e antologji dhe janë dalluar për ndjeshmëri të hollë dhe kulturë e njohje traditash botërore. Pra, i është avitur një fushe, për të cilën jo vetëm zotëron kompetencën e nevojshme përkthimore (nga njohja me letërsinë dhe gjuhën e asaj letërsie), por ka edhe përvojën e vet krijuese të drejtpërdrejtë si poet.

Krahas parapëlqimeve të veta në poezi, zgjedhja e dytë është vetë objekti i studimit: vështrimi analizues/shqyrtues dhe interpretues mbi traditën e përkthimeve në shqip - nga poezia ruse. Dihet se kjo traditë përkthimore, rezulton të jetë mjaft e pasur, ku spikasin emra autorësh të shquar, si: Lasgush Poradeci, Jorgo Bllaci, Ismail Kadare, Vedat Kokona, Dritëro Agolli, Dhori Qiriaz, Vangjush Ziko, Agim Shehu... etj, të cilët, kanë bërë të mundur të flasin mrekullisht në shqip poetë me famë botërore si: Pushkin, Bllok, Esenin, Bagricki, Majakovski... Kjo përzgjedhje e përkorë, prej majave të kësaj letërsie, shkante në simetri me përkthime në shqip të autorëve të tjerë të huaj, të përmasave botërore, si: Homer, Safo, Dante, Gëte, Hygo, Bajron, Haine, Eminesk, Petëf, Miskieviç, Uitman etj.

Kuptohet, periudha pas viteve ‘90, do të sillte edhe nga poezia ruse, ashtu si prej letërsive të tjera botërore, përkthime të atyre veprave apo të atyre autorëve, që më parë, quheshin *zona të ndaluara* apo autorë të mallkuar. Një vështrim qëmtues, i hollësishëm i kushtohet në këtë studim monografik pikërisht këtyre

poetëve rusë, të panjohur deri më sot, përcjellë nga përkthyes të ndryshëm në gjuhën shqipe.

Një vlerë veçmas e spikatur e këtij libri mendojmë të jetë, mbi të gjitha, vështirimi krahasues, sepse, duke hulumtuar në morinë e përkthimeve nga poezia ruse nëpër vite, ai shfaq njëherazi edhe një histori të zhvillimit të kësaj krijimtarië, me variacione prirjesh e luhatjesh stilistikore nga njëra epokë letrare në tjetrën, duke nisur nga qindvjetëshi i ashtuquajtur *i artë* (shek. XIX), që pati për kurorë Pushkinin, tek qindvjetëshi *i argjendë* (shek. XX) me kulm Ahmatovën, Pasternakun, Cvetajevën e të tjerë autorë me emër. Ndërkaq, ky zhvillim i bujshëm poetik, nga ana e vet, pas ngjarjeve të Revolucionit të Tetorit, do të thërrmohet fatalisht, m'u si një servis kristali nga përplasja me një mur hekuri, situatë e rëndë kjo, që do t'i hapë udhë atij procesi letrar që erdhi më pas, i cili, me gjuhë metafore do të emërtohet si qindvjetëshi *i hekurt*. Pra, është koha, kur nis të krijohet ajo letërsi e projektuar dhe e orientuar brenda kanoneve të realizmit socialist, e skematizuar, ashtu si brenda vet shtratit mitologjik të Prokrustit.

Informacioni i këtij studimi, zgjerohet edhe me identifikimin e atyre autorëve, që shkruajnë brenda formatit estetik të shkollave e drejtimeve të udhëhequr nga manifestet e tyre të njohura letrare si: simbolizmi, akmeizmi, futurizmi, lëvizje të njohura këto, që patën jehonë e ndikim edhe në Evropë, në dekadat e para të shek. XX. Në këtë qasje, kjo poezi e pasur e botës ruse, vështrohet realisht, si një proces i gjallë e dinamik, me tërë baticat dhe zbaticat e veta estetike. Prandaj e ritheksoj se kontribut i spikatur dhe kryesor i këtij libri mbetet pikërisht kjo analizë krahasuese nëpër përkthimet e kohëve të ndryshme të poezisë ruse në gjuhën shqipe.

Tradita jonë përkthimore i ka njohur të dy modelet tipike (kanonike): ato që ndjekin besnikërisht origjinalin dhe ato që rindërtojnë tekstura të lira, duke ruajtur kryesisht frymën estetike dhe disa bërthama emocionale dhe stilistike prej krijimeve të gjuhës, ku ato janë endur artistikisht. Studiuesi i vlerëson të dyja përvojat, por i ka të qarta limitet, të cilat nuk mund të tejkalohen dot në secilin rast, sepse ndryshe, krijohen tekste artifice, pra, shkarje apo largime *in ekstemis* nga veprat origjinale. Gjithsesi, duket me vend pikëpamja shqetësuese e autorit të studimit, për nevojën e ruajtjes doemos të strukturës poetike origjinale në

procesin e përkthimit, si një integritet artistik letrar ky - i pacenueshëm në thelbin e vet gjenuin. Në fund të fundit, çdo krijim poetik, sipas studiuesit, duhet të vijë në shqip, sikundër dhe në çdo gjuhë tjetër, si një lojë e ndërthurur mjeshtërisht e formateve të dukshëm dhe të padukshëm, e fonemave dhe morfemave, e kadencave meloritmike, valencave kuptimore, toneve dhe gjysmëtoneve, aliteracioneve, sekuencave gjuhësore, të nxjerra në pah me qëllim, apo të futura rastësisht, që së toku, ato të përcjellin në mënyrë të shkallëzuar tërë gamën muzikore të gjuhës amë.

Në përfundim, pa u zgjeruar më tej me argumente të tjera, kemi mendimin se ky libër vjen si një studim i rëndësishëm dhe i dobishëm, i cili përcjell një problematikë të rëndësishme, siç është ajo e përkthimeve letrare në shqip. Përkthime këto, që sot janë shtuar aq shumë, por që kanë në jo pak raste përcjellje jo profesionale për te lexuesi, i cili, nga ana e vet, kur nuk e ka informacionin e duhur, këtë nivel inferior të teksteve poetike të përkthyer (madje edhe kur janë të autorëve të shquar), padrejtësisht e gabimisht, ua faturon pikërisht këtyre autorëve dhe jo përkthyesve dorëlëshuar.

Mendojmë se studime të tilla janë manuale të vërteta pune dhe mjaft të dobishme, ato marrin vlerë sidomos në duart e përkthyesve të rinj, për t'i njohur e çmuar/vlerësuar traditat dhe arritjet tona përkthimore, por edhe për t'i çuar ato akoma më tej.

Prof. Dr. Ymer Çiraku